

ABSTRAKT

PADITË PRONËSORE DHE APLIKUESHMËRIA E TYRE NË PRAKTIKË

Mentori: Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha

Kandidatja: Bsc Shqiponjë Pllana

E drejta e pronësisë është një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës. Kjo e drejtë është një nga institutet më të vjetra që buron që nga periudha e të drejtës romake por që në zanafillë ka lindur me lindjen edhe të vetë të drejtës.

E drejta e pronësisë dhe mbrojtja e saj janë të drejta kushtetuese sepse garantohen me kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 46 thotë “E drejta e pronës është e garantuar”.

Duke marrë parasysh se e drejta e pronësisë dhe mbrojtja e saj nuk bën të trajtohen ndaras e kemi filluar këtë punim duke shpjeguar disa koncepte bazike në lidhje me të drejtën e pronësisë, nocionin, kuptimin dhe karakteristikat e të drejtës së pronësisë. Mirëpo në fokus të temës sonë është mbrojtja e të drejtës së pronësisë në procedurë kontestimore përmes mekanizmit të gjykatës duke ushtruar mjetin procedural “paditë pronësore”.

Në procedurë kontestimore kemi lloje të ndryshme të padive por llojet të cilat aplikohen më së shpeshti në praktikë janë: padia për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, padia për kthimin e sendit dhe padia për pengim posedim.

Problemet në lidhje me pronësinë vazhdimisht e kanë përcjellë Kosovën e sidomos pas periudhës së vitit 1999 kur Kosova ishte nën administrimin ndërkombëtar të UNMIK-UT, lufta e fundit në Kosovë, shpronësimi i madh i njerëzve nga pronat e tyre, shkatërrimi i dokumenteve, mungesa e kontratave formale dhe zhvendosja e librave të kadastrit ka bërë që gjykatat tona departamentet civile të stërmbushen me lëndë nga kontestet pronësore. Andaj në këtë aspekt kemi parë të arsyeshme ta trajtojmë këtë temë në mënyrë që të gjendet një zgjidhje që gjyqësori të lirohet nga ky numër i madh i kontesteve pronësore.

Kjo temë ka për qëllim që përmes një hulumtimi të zhvilluar online përmes nxjerrjes së aktgjykimeve të publikuara të tregoj se cilat janë problemet me të cilat ballafaqohen palët më shpesh në praktikë në tentim për ti mbrojtur të drejtat e tyre pronësore. E që në bazë të hulumtimit rrjedh se problemet me të cilat janë ballafaquar më shpesh palët janë mungesa e kontratave formale me shkrim dhe pretendimi i palëve se pronësinë e kanë fituar me parashkrim fitues me mirëbesim në periudhën prej 20 viteve, por natyrishtë nuk ngelet mbrapa as problemet në lidhje me pengim posedimin.

Fjalët kyçe: pronësia, mbrojtja e pronësisë, paditë pronësore, procedura kontestimore

